



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 30311 Prot.

Vlorë, më 05.07.2019

**VENDIM**

**Nr. 31, datë 05.07.2019**

**PËR  
MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLOREN PËR ZGJEDHJEN E  
KËSHILLAVE STUDENTORË NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË**

Mbështetur në shkronjën d, pika 1, nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 19 në Statutin e Universitetit 'Ismail Qemali', Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 05.07.2019

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndryshimin e nenit 29 në Rregulloren për zgjedhjen e këshillave studentorë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë si më poshtë:

**Neni 29**

1. Pas përfundimit të afateve të apelimit, organizohet mbledhja e parë e Këshillit Studentor të UV-së, e cila thërritet nga KIZS-ja jo më vonë se dy javë nga ky afat. Në këtë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët e këshillit studentor të UV-së, të shpallur fitues. Në këtë mbledhje bëhet konstituimi dhe, më pas, caktohet data e mbledhjes së dytë në të cilën zgjidhet kryetari i KSUIQV-së. Në mbledhjen e dytë anëtarët e KSUIQV-së zgjedhin mes tyre me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë votash, kryetarin e Këshillit Studentor të UV-së, i cili vetëkandidohet ose propozohet nga anëtarët e këshillit. Mandati i kryetarit të KSUIQV-së është 2 vjeçar.
2. Shfuqizohet.
3. Sekretari i Këshillit studentor të UV-së zgjidhet në po të njëjtën mbledhje e në të njëjtën mënyrë, një nga anëtarët e KSUIQV-së i cili vetëkandidohet ose propozohet nga anëtarët e këtij këshilli. Mandati i sekretarit është 2 vjeçar.
4. E njëjta procedurë zbatohet edhe për zgjedhjen e kryetarit dhe sekretarit të Këshillave Studentorë të Fakulteteve.
5. Selia ku do të bëhet mbledhja e Këshillit Studentor të UV caktohet nga Rektori, ndërsa e Fakulteteve e vendos Dekani jo më vonë se 2 ditë pasi është caktuar data e mbledhjes të parë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**SENATI AKADEMIK**

2. Vendimi protokollet dhe përcillet për zbatim Zv/rektorit akademik, KIZS-së dhe këshillave studentorë të njësive kryesore dhe UV-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Roland ZISI**

